

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, PËR MBROJTJEN SHOQËRORE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KANADASË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë. Ky projektligj është inicuar në zbatim të angazhimit të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen shoqërore të emigrantëve, e cila rregullohet nëpërmjet aderimit në instrumentet ligjore ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes shoqërore, nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve respektive, si dhe nga legjislacioni kombëtar.

Gjatë negociimit të marrëveshjes janë zbatuar rregullat për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar dhe për anëtarët e familjeve të tyre, të cilët lëvizin brenda komunitetit, që janë percaktuar në rregulloren e Këshillit nr.1408/71 dhe rregulloren nr.883/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është pjesë e procesit të koordinimit të skemave të mbrojtjes shoqërore, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, ashtu siç është parashikuar në programin politik të qeverisë. Pas përfundimit të procesit të diskutimit dhe parafimit të tekstit të marrëveshjes së mbrojtjes shoqërore, ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë, në Tiranë, në datat 1-4 dhjetor 2014, ku u miratua edhe rregullorja administrative që shërben për zbatimin e marrëveshjes.

Marrëveshja u miratua, në parim, me vendimin nr.336, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, dhe u nënshkrua më 30.4.2019, në Kanada, nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë dhe ministri i Punëve të Jashtme Kanadeze. Pas nënshkrimit, ratifikimi është procesi përfundimtar me anë të të cilit Kuvendi i Shqipërisë jep miratimin përfundimtar të projektligjit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Marrëveshja për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë, konsiston në ofrimin e përfitimeve në sigurimet shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, trajtimin me përfitime dhe të ardhura. Gjithashtu, rregullat koordinuese garantojnë që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre e të mbijetuarit, të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar. Bashkimi i periudhave të siguruara, sipas legjislacioneve kombëtare të ndryshme, të merren në konsideratë, për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre.

Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe akti i sigurimeve për të moshuar e plani kanadez i pensionit, në Kanada. Palët kanë rënë dakord të japin përfitime në para për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare, bazuar në legjislacionet respektive të mbrojtjes shoqërore.

Në pjesën e parë të marrëveshjes, dispozitat e përgjithshme, përcaktohen përkufizimet për legjislacionin, autoritetet dhe institucionet kompetente të të dyja vendeve, parimi i trajtimit të barabartë si dhe ai i transferimit të përfitimeve.

Në pjesën e dytë përcaktohen dispozita në lidhje me legjislacionin e zbatueshëm të të dyja vendeve dhe dispozita të veçanta për trajtimin e personave të punësuar dhe të vetëpunësuar, nëpunësit e shërbimit civil, ekuipazheve të anijeve dhe avionëve dhe punëtorëve të dërguar nga punëdhënësi për të punuar për llogari të tij në vendin tjetër.

Pjesa e tretë ka të bëjë me dispozitat në lidhje me përfitimet, për bashkimin e periudhave të sigurimit, për përfitimin e pensionit të pleqërisë, pensionit familjar dhe atij të invaliditetit si dhe llogaritjet e pensioneve, sipas legjislacionit kanadez dhe atij shqiptar.

Në pjesën e katërt përfshihen dispozita të ndryshme administrative, lidhur me përgjegjësitë e autoriteteve kompetente, shkëmbimet e informacionit, ankimet, mënyrën e pagesës së përfitimeve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve etj.

Për vetë veçoritë e administrimit territorial dhe juridik të Kanadasë, në nenin 25 të projekt marrëveshjes përcaktohet se Shqipëria mund të realizojë marrëveshje me çdo provincë në Kanada, për çështje të mbrojtjes shoqërore, me kusht që ajo të mos jetë e papajtueshme me këtë marrëveshje.

Pjesa e pestë dhe e fundit ka të bëjë me dispozitat kalimtare dhe përfundimtare për kohëzgjatjen, ndërprerjen dhe hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në dispozitat e kësaj marrëveshjeje dypalëshë reflektohen të gjitha rregullat për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore, për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar dhe për anëtarët e familjeve të tyre, të cilët lëvizin brenda komunitetit, të cilat janë përcaktuar në rregulloren e Këshillit nr.1408/71 dhe rregulloren nr.883/2004, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian. Dispozitat e marrëveshjes harmonizojnë, gjithashtu, legjislacionet kombëtare të të dyja vendeve për përfitimet që kanë të bëjnë me sëmundjet, barrë lindjet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore.

Dispozitat e marrëveshjes respektojnë Kushtetutën dhe parimet e saj. Gjithashtu, ato respektojnë dhe zhvillojnë të drejtat e fituara në koherencë me zhvillimet ekonomike e financiare të vendit. Këto dispozita respektojnë parimet buxhetore të financimit të shpenzimeve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si edhe të dispozitave ligjore në fushën e administrimit financiar e kontrollit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE

Ky projektligj nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në fillim të marrëveshjes përcaktohen dispozitat e përgjithshme, që përfshijnë përkufizimet, hapësirën ligjore, parimin e trajtimit të barabartë, transferimit të përfitimeve etj. Të gjithë personat e përfshirë me këtë marrëveshje do të trajtohen në mënyrë të barabartë prej palëve kontraktuese, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet për plotësimin e kushteve dhe pagesën e përfitimeve që rrjedhin drejtpërdrejt prej legjislacionit të palëve kontraktuese ose sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Përfitimet e fituara në bazë të legjislacionit të njëjës palë kontraktuese nuk mund të reduktohen, të ndryshohen, të ndërpriten apo të anulohen, për shkak se

përfituesi ka vendqëndrim në territorin e palës tjetër kontraktuese, vetëm nëse nuk është parashikuar ndryshe me këtë marrëveshje.

Për personat që kanë të drejtën e përfitimit nga njëra palë kontraktuese, transferimi i përfitimit bëhet në kushte të njëjta edhe në rastet kur ata jetojnë në një shtet të tretë.

Në nenin 12 të marrëveshjes përcaktohet e drejta për:

- një përfitim sipas aktit të sigurimeve për të moshuar, ku Kanadaja do të konsiderojë një periudhë të vlefshme sipas legjislacionit shqiptar për periudhën e banimit në Kanada;
- një përfitim bazuar në planin kanadez të pensioneve, Kanadaja do të njohë një vit kalendarik që përfshin të paktën 90 ditë e që janë periudha të vlefshme sipas legjislacionit shqiptar si një vit kalendarik, i cili është i vlefshëm sipas planit kanadez të pensioneve.

Për të përcaktuar të drejtën për një përfitim për pleqëri, invaliditet apo familjar bazuar në legjislacionin shqiptar:

- Shqipëria do të njohë një vit kalendarik, që është periudhë e vlefshme sipas planit kanadez të pensioneve si 12 muaj që janë të vlefshëm sipas legjislacionit shqiptar;
- Shqipëria do të njohë një periudhë përgjatë së cilës është paguar një përfitim invaliditeti bazuar në planin kanadez të pensioneve, si periudhë të vlefshme sipas legjislacionit shqiptar, nëse ajo periudhë e pagesës së përfitimit të invaliditetit nuk mbivendoset me një periudhë të vlefshme bazuar në planin kanadez të pensioneve.
- Shqipëria do të njohë një periudhë, që është periudhë e vlefshme bazuar në aktin e sigurimeve për të moshuar të Kanadasë, si periudhë e vlefshme sipas legjislacionit shqiptar, nëse ajo periudhë e vlefshme sipas aktit të sigurimeve për të moshuar nuk mbivendoset me një periudhë të vlefshme sipas planit kanadez të pensioneve ose si një periudhë gjatë së cilës është paguar një përfitim invaliditeti sipas planit kanadez të pensioneve.

Periudhat e sigurimit, të plotësuara sipas dispozitave ligjore të të dyja palëve kontraktuese, kur kjo nevojitet, bashkohen për realizimin e së drejtës së përfitimit dhe përcaktimin e kohëzgjatjes së këtij përfitimi, me kusht që ato të mos mbivendosen. Periudhat e sigurimit bashkohen në rastet e përfitimit të pensionit të pleqërisë, të invaliditetit dhe atij familjar, të sëmundjeve e të barrëlindjes.

Gjithashtu, përcaktohen detyrimet për t'u siguruar në bazë të dispozitave ligjore të palës kontraktuese në territorin e të cilit ai punon. Ky sigurim vlen edhe në rastet kur adresa e punëdhënësit gjendet në territorin e palës tjetër kontraktuese, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në marrëveshje.

Miratimi i kësaj marrëveshjeje do të krijojë mundësinë e përfitimit të pensioneve për shqiptarët që jetojnë e punojnë në Kanada, si dhe të shtetasve kanadezë të cilët vijnë për të punuar në Shqipëri, si të punësuar nga kompani investitore në industrinë nxjerrëse, minerare e energjetike, apo të vetëpunësuar. Gjithashtu, krijohen hapësira ligjore për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë, përveçse në Kanada edhe në vendet e tjera me të cilët të dyja vendet kanë marrëveshje dypalëshe.

Këtyre personave, e drejta për përfitime nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore iu lind në momentin kur ata të kenë mbushur moshën për pension. Sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të gjithë këta persona do të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore shqiptare nëse kanë mbi 15 vite pune të siguruara.

Në pjesën e katërt e të pestë të marrëveshjes përfshihen dispozita të ndryshme lidhur me përgjegjësitë e organeve kompetente, ankimet, mënyrën e pagesës së përfitimeve, mbrojtjen e të dhënave personale, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, kohëzgjatjen e marrëveshjes dhe hyrjen në fuqi të saj.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 të marrëveshjes janë përcaktuar organet kompetente, të cilat janë përgjegjëse në lidhje me fushën e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe konkretisht:

- Për Kanadanë, ministri ose ministrat përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të Kanadasë;
- Për Republikën e Shqipërisë, ministri ose ministrat përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes shoqërore.

Në nenin 2 janë përcaktuar institucionet kompetente të cilat do të zbatojnë marrëveshjen e mbrojtjes shoqërore dhe nënkuptojnë:

- Për Kanadanë, autoritetin kompetent;
- Për Shqipërinë, institucionin përgjegjës për zbatimin e legjislacionit.

Në zbatim të marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore është parafimuar edhe rregullorja administrative, ndërmjet Departamentit të Punësimit dhe Zhvillimit Social, në Kanada, dhe ish-Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në Shqipëri, për zbatimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë.

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe veprimet analitike të autoriteteve kompetente e agjencive ndërlidhëse, që, për Republikën e Shqipërisë, është Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe për Kanadanë, Divizioni i Veprimtarive Ndërkombëtare, Shërbimi Kanadez, Departamenti i Punësimit dhe Zhvillimit Social, Drejtoria e Politikave Ligjore dhe Agjencia Kanadeze e të Ardhurave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në grupin teknik të punës për hartimin e marrëveshjes dypalëshe të mbrojtjes shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë, i cili drejtohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka përfaqësues të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Nga zbatimi i marrëveshjes, për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës të Shqipërisë dhe Kanadasë, nuk do të ketë efekt financiar të menjëhershëm, pasi e drejta për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore shtetasve shqiptarë iu lind në një periudhë të dytë, kur ata të kenë mbushur moshën për pension. Sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të gjithë këta persona do të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore shqiptare nëse do të kishin 15 e më shumë vite pune të siguruara.

Nga të dhënat e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kanada janë rreth 60 mijë shqiptarë të cilët jetojnë në Kanada.

Duke pasur parasysh që emigrantët shqiptarë që kanë periudha sigurimi janë relativisht të rinj dhe duan të paktën 6-10 vjet për të dalë në pension, efektet financiare do të fillojnë pas kësaj periudhe. Kostot administrative për zbatimin e kësaj marrëveshjeje mbulohen nga institucionet zbatuese të secilës palë.

KËSHILLI I MINISTRAVE